



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

Mars, 2018

7 Marsi kujtohet në mënyrë madhështore nga SBASHK-u  
**Respekt i përherëshëm për pishtarët e dijes**



Krahas aktiviteteve e angazhimeve të shumta në shërbim të anëtarësisë, SBASHK-u vazhdon me organizimin e Manifestimeve e Konferencave duke dëshmuar përkushtim e entuziazëm për organizim madhështor të ngjarjeve të tilla. Një aktivitet i tillë madhështor është organizuar nga SBASHK edhe më 7 Mars në ambientet e Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë SBASHK-u ka për ditën e mësuesit dhe shkollës shqipe. Ky manifestim mbahet tradicionalisht në ... (faqe 5)

Duke respektuar zërin e anëtarësisë

**SBASHK-u vazhdon me veprimet sindikale**



Pasi që i kishin dhënë kohë dhe hapësirë të konsideruar dialogut me institucionet ....(faqe 8)

Ministri Bytyqi ka organizuar takim të nivelit të lartë për arsim

**SBASHK-u alarmoi se nëse nuk ka reflektim do të ketë grevë në kohë të pacaktuar**

Ministri i arsimit , Shyqyri Bytyqi ka organizuar një takim të nivelit të lartë ... (faqe 11)

Intervistë me juristin e SBASHK-ut, z.Blendor Shatri

**Ndjehem mirë kush shoh gëzimin në fytyrat e mësimeve pas fitoreve në gjykata**

Blendor Shatri është juristi i SBASHK-ut. Ai punon me përkushtim dhe falë sjelljeve korrekte me palët gëzon respekt të të gjithë. Ka krijuar përvojë .... ( faqe 3)

Dy takime të rëndësishme të Këshillit të ri Drejtues

**Nënkryetare u zgjodh Vjollca Shala e sekretare e përgjithshme Jehona Oruqi**



Këshilli i ri Drejtues i SBASHK-ut ka zhvilluar dy takime në të njëjtën ditë në sallën ... (faqe 9)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës  
The Union of Education, Science and Culture

## Editorial

### Lexova në sytë e pishtarëve të dijes



Pikërisht më 7 mars SBASHK-u organizoi në Pallatin e Rinisë në kryeqytetin e shtetit tonë një takim madhështor me koleget e kolegët tonë që janë pensionuar nga fundi i marsit të vitit të kaluar e deri në marsin e këtij viti. Kishte shumë emocione . Kolegët tanë vinin nga gjithë komunat e Kosovës dhe në platon e këtij tempulli të rinisë takoheshin. Kishte vite e vite që nuk ishin parë dhe me emocione pyetnin njëri-tjetrin si me frikë se a je ti ai që po mendoj. Bisedat nuk kishin të ndalur. Ata shetitnin nëpër

vite e ndaleshin të koha e rinisë dhe e studimeve.

Emocionet shiheshin edhe në sallën e takimit. Qindra pensionist po kremtonin ditën e madhe të shkollës shqipe dhe ndjeheshin krenar që për vite e dekada i shërbyen arsimimit të brezave. Ata bashkërisht kujtonin me krenari qëndresën heroike të punëtorëve të arsimit në vitet e 90-ta. Kujtonin këta pishtarë të dijes dhe lartësonin kujtimin për të gjithë ata që tani më nuk janë mes nesh.

Manifestimi ishte vërtetë madhështor. U shpreh respekti i merituar për gjithë ata që i dhanë dritë ardhmërisë duke e mposhtur errësirën. Këta njerëz qendronin ballëhapur sepse nuk i kanë mbetur borxh atdheut dhe popullit të tyre. I përhershëm mbetet respekti për pishtarët e dijes.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)**

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940





## Intervista

*Intervistë me juristin e SBASHK-ut, z.Blendor Shatri*

### Ndjehem mirë kush shoh gëzimin në fytyrat e mësimeve pas fitoreve në gjykata



*Blendor Shatri është juristi i SBASHK-ut. Ai punon me përkushtim dhe falë sjelljeve korrekte me palët gëzon respekt të të gjithë. Ka krijuar përvojë të mirë edhe në paraqitjet në gjykata si përfaqësues i SBASHK-ut e duke*

*mbrojtur kolegët tanë lidhur me pagat përcjellëse e suplementare, por edhe në rastet kur dikujt i shkelen të drejtat e punës. “Nuk është e lehtë kjo punë, por ndjej gjithmonë kënaqësi sepse jam gjithmonë në anën e te drejtës”, shprehet Blendori*

#### **Arsimimi sot:**

Kush është Blendor Shatri?

#### **Blendori:**

Kam lindur më 22.11.1989 në Istog, Kam përfunduar shkollën fillore në SHFMU “Martin Camaj” në Gurrakoc, shkollën e mesme në gjimnazin “Haxhi Zeka” në Istog, i diplomuar në Universitetin e Prishtinës, përkatësisht Fakulteti Juridik - jurist i diplomuar, po ashtu vazhdoj studimet Master në drejtimin administrativ kushtetues. Punoj në SBASHK në cilësinë e Juristit që nga viti 2015

#### **Arsimimi sot:**

Cilat janë çështjet juridike të anëtarësisë, me të cilat jeni marr më së tepërmi gjatë kësaj kohë sa jeni në SBASHK?

#### **Blendori:**

Përveç çështjeve administrative që janë të lidhura me punën time në zyrë (hulumtimet në fushën e të drejtave të punëtorëve, përpilimi i vendimeve teëbrendshme të SBASHK-ut, dhe detyrave tjera që janë në përgjegjësitë e mija si jurist i SBASHK-ut,

Një pjesë të mirë të angazhimeve të mija e kaloj në Gjykata duke i mbrojtur të drejtat e anëtarëve tonë me çështjet që kanë të bëjnë me problemet nga marrëdhënia e punës si dhe me anëtarët tanë tanimë të pensionuar për çështjen e pagave për përcjellje në pension dhe shpërblimeve jubilarë. Nuk është e lehtë kjo punë, por ndjej gjithmonë kënaqësi sepse jam gjithmonë në anën e te drejtës.

#### **Arsimimi sot:**

A e dini sa lëndë i keni dërguar në Gjykatë deri tani?

#### **Blendori:**

Gjatë periudhës prej qe kam filluar punën në SBASHK në Gjykata janë dorëzuar 24 padi kolektive me gjithsejtë 560 pensionistë në kuadër të këtij angazhimi paditë janë dorëzua për këto komuna: Vushtrri me gjithsej 13 pensionistë, Viti 39 pensionistë, Shtime 16 pensionistë, Skenderaj 18 pensionistë, Rahovec 24 pensionistë, Prizren 42 pensionistë, Prishtinë 39 pensionistë, Podujevë 23 pensionistë, Pejë 74 pensionistë, Novobërdë 2 pensionistë, Mitrovicë 32 pensionistë, Malishevë 28 pensionistë, Leposaviq 1 pensionistë, Kamenicë 8 pensionistë, Kaçanik 10 pensionistë, Junik 3 pensionistë, Hani I Elezit 3 pensionistë, Gjilani 36 pensionistë, Gjakova 77 pensionistë, Glllogovci 5 pensionistë, Fushë Kosova 2 pensionistë, Ferizaj 48 pensionistë, Deçani 25 pensionistë, Agjencioni i kompetencës dhe Ministria e Arsimit 7 pensionistë.

Në vazhdimësi u kemi përgatitur anëtarëve tanë edhe padi individuale që përfaqësisht jam përgatitur mbi 200 padi individuale.

Nga këto raste të padive individuale kanë përfunduar kaq raste nëpër komuna: Në Komunën e Prishtinës 4 raste, të cilat ndodhën në Gjykatën e Apelit pas ankesës nga Komuna, Vushtrri 1 rast, vendimi i plotfuqishëm, Kamenicë 3 raste pozitive nga

Gjykata Themelore „Drenovc 2 raste pozitive nga Gjykata Themelore.

Po ashtu kemi paraqitur edhe disa padi që kanë të bëjnë me probleme të anëtarëve tanë gjatë procesit të punës , padi për të cilat jemi në pritjeve për thirrje për shqyrtimin kryesor .

## **Arsimimi sot:**

Sa nga këto lëndë janë të përfunduara, sa janë në proces gjyqësor dhe sa ende nuk kanë filluar?

## **Blendori:**

Deri me tani janë shqyrtuar paditë vetëm në komunat e Vushtrrisë , Skenderajt , Kamenicës , Fushë Kosovës , Shtimes dhe Rahovecit . Ne të gjitha këto komuna është dhënë Aktgjykim pozitiv në të mirë te pensionistëve anëtarë të SBASHK-ut

Komuna e Vushtrrisë dhe Fushë Kosovës nuk janë ankuar në Gjykatën e shkallës së dytë ku pensionistët i kanë marr pagat përcjellëse në pension si dhe shpërblimet jubilarë .Ndërsa komunat tjera e kanë Apeluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore ku pritet vendim pozitiv edhe nga kjo gjykatë siç po ndodh çdo ditë në rastet individuale që po shqyrtohen . Pjesa tjetër e Padive kolektive ende nuk kanë filluar te shqyrtohen nga Gjykatat përkatëse .Po ashtu një numër i madh i padive individuale nëpër shumicën e komunave të Kosovës kanë marrë Aktgjykim pozitiv nga Gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe nga Gjykata e shkallës së dytë cilat vendime janë ekzekutuar .

## **Arsimimi sot:**

Deri më tani a ka ndonjë lëndë që nuk u zgjedh në të mirë të palës (anëtarit të SBASHK-ut) nëse ka qenë kërkesa në kuadër të Kontratave Kolektive?

## **Blendori:**

Deri me tani kemi marrë Aktgjykime Pozitive në të gjitha lëndët të cilat i kemi dërguar në Gjykata e që kanë të bëjnë me çështje te cilat i parasheh Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar e vitit 2014 dhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e vitit 2017 .

## **Arsimimi sot:**

A jeni i kënaqur me punën që po bëjnë Gjykatat, duke pasur parasysh se janë të stërngarkuara me lëndë?

## **Blendori:**

Jam pjesërisht i kënaqur me punën e Gjykatave sa i përket kohës se shqyrtimit të Padive që i kemi dërguar për shkak se me Ligjin e procedurës civile lëndët që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës duhet të shqyrtohen me urgjencë . Mirëpo jemi të kënaqur me raportin profesional që kanë Gjyqtaret me ne .

## **Arsimimi sot:**

A keni diçka për të shtuar?

## **Blendori:**

Shpresoj që sa i përket çështjeve të cilat i rregullon Kontrata Kolektive e Arsimit të mos ketë nevojë të kemi procese Gjyqësore , por këto të drejta të realizohen në mënyrë të vullnetshme nga punëdhënësit.

## Gjatë muajit

### 7 Marsi kujtohet në mënyrë madhështore nga SBASHK-u **Respekt i përherëshëm për pishtarët e dijes**

*Krahas aktiviteteve e angazhimeve të shumta në shërbim të anëtarësisë, SBASHK-u vazhdon me organizimin e Manifestimeve e Konferencave duke dëshmuar përkushtim e entuziazëm për organizim madhështor të ngjarjeve të tilla. Një aktivitet i tillë madhështor është organizuar nga SBASHK edhe më 7 Mars në ambientet e Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë SBASHK-u ka për ditën e mësuesit dhe shkollës shqipe. Ky manifestim mbahet tradicionalisht në shenjë respekti për punëtorët arsimor të pensionuar nga marsi i vitit të kaluar e deri në marsin e këtij viti.*



*“Sot e gjithmonë e të gjithë bashkë kujtojmë me respekt mësimdhënësit e parë të shkollës shqipe, kujtojmë mësuesin e dëshmorin e kombit Shaban Jashari dhe mësuesit e atdhetarët e tjerë që me pendë e pushkë i dolën zot atdheut.*



*Ju kolege e kolegë , që u pensionuat që nga marsi i vitit të kaluar e deri tani qëndroni ballëhapur sepse atëherë kur e kërkoji atdheu, kombi dhe koha ju u kthyet në mburojë të fuqishme në mbrojtje të arsimit shqip në vitet e vështira të okupimit dhe në emër të kryetarit, Kryesisë , këshillit Drejtues dhe gjithë anëtarëve të SBASHK-ut ju faleminderit për përkushtimin. dhe prandaj Gëzuar festën e madh të shkollës shqipe.”, ka thënë në hapje të manifestimit moderatorja, Nezafete Jakupi për të ftuar pastaj kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj për fjalën përshëndetëse.*



“Punëtorët e arsimit as edhe një herë nuk i kanë mbetur borxh atdheut. Ata në kohët më të vështira e kanë mposhtur errësirën dhe i kanë hapur rrugë dritës. Ata në zemër kanë ruajtur alfabetin, kulturën , arsimin dhe kanë mbajtur gjallë ëndrrën për liri, që falë

bijave e bijve më të mirë të këtij trualli dhe ndihmës së miqve të vërtetë u kthye në realitet. Tani kur Kosova frymon lirshëm dhe tingëllon bukur zilja e shkollës dhe dëgjohet buzëqeshja e zëri i lumtur i nxënësve tanë shtrohet vetvetiu pyetja se a u doli borxhit shteti ynë këtyre pishtarëve të dijes. Institucionet e shtetit tonë nuk kanë bërë sa duhet për ta dëshmuar respektin që meritojnë njerëzit e asaj kohe. Vitet e 90-ta dhe puna e përkushtuar e plot sakrificave e mësimdhënësve të asaj kohe duhet të shënohet në libra , të mbrohet me dokumente e ligj dhe të ruhet në kujtesën tonë sepse e tërë bota u mahniti me përkushtimin dhe sakrificën e njerëzve të dijes në gjithë ato vite. Qeveria dhe institucionet e Kosovës “, është shprehur Jasharaj.

Në fjalën përshëndetëse kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj është shprehur i lumtur që gjendet



në këtë ceremoni madhështore kushtuar një date të veçantë për arsimin tonë.



“Ndihem sot edhe nxënës edhe prind por edhe kolegë me ju, bashkëndej me juve. Bashkëndej me ata që vazhduan rrugën, me ata që dhanë shtëpitë e tyre. Pa punën e juaj nuk do të ishim këta që jemi. E ndjej që kemi përgjegjësi. Qeveria e Kosovës nuk është e ndarë, nuk është larg jush. Na dhemb ajo që ju dhemb juve, na dhemb infrastruktura, kushtet e fëmijëve. Nuk na vjen mirë kur na vlerësojnë fëmijët dobët PISA ose programe të tjera. Nuk kemi bërë shkarkim të bordit por duhet me i ndihmu vendit me ecë përpara. Pa u zbatuar e drejta juaj, e pensionit e stazhit, ju siguroj se s’do të ndalemi pa e bërë. Pa shkollë të fortë nuk ka popull të fortë, nuk ka shtet të fortë, ekonomi e as ushtri të fortë, sepse vetëm duke pasur shkollën e fortë do të jemi të zotët e vetës.”, ka thënë Kryeministri Haradinaj.



“Ne jemi këtu ne saje të punës tuaj dhe u jemi mirënjohës për jetë. Uroj që këta punëtor të vyer të arsimit që kaluan sakrifica pëe tiu mësuar gjeneratave alfabetin e gjuhës. Ju i mësuar hapat e

parë edhe gjeneratës së lirisë. Sindikatat janë rregullatori i cilësisë dhe mirëqenies. Ne me detyrat tona, dua të siguroj që dikasteri ynë do të jetë edhe shtëpia juaj. Kemi shumë punë për të bërë., ka deklaruar para pishtarëve të dijes, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica.



“Sot po shënojmë ditë të veçantë dhe po kujtojmë kontributin e mësuesve. Duke qenë se kjo festë lidhet me epopën e UÇK-së.. Mësuesit ishin kyçur edhe drejtpërdrejt në luftën çlirimtare. Ministri ka krijuar komisionin. Po punojmë që të kemi kurrikula të standardizuara. Baza e një arsimit cilësor jeni ju mësues”, ka thënë Fehmi Hysenaj, shef i kabinetit të MASHT-it.



Rektori i UP-së, Marjan Dema, ka thënë në fjalën e tij përshëndetëse se ndjehet i nderuar që sot po merr pjesë në këtë takim madhështor me pishtarët e dijes. “Mësimdhënia është profesioni më i çmueshëm. Punonjësit e sistemit arsimor përbëjnë një hallkë të rëndësishme për strukturën e shtetit. Në procesin e edukimit roli i sindikatës është i rëndësishëm. Edhe

sot sfidat në arsim janë. Jemi të përkushtuar që duke ndryshuar UP-në ta ndryshojmë edhe Kosovën. Të qëndrojmë të bashkuar për një arsim sa më cilësor”, tka thënë rektori Dema.



Kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim, Ismajl Kurteshi. Ka shpalosur kujtime nga e kaluara e arsimit shqip duke thënë se punëtorët e arsimit nëpër vite, dekada e shekuj kanë mbrojtuar arsimin dhe kulturën e kombit tonë. Ai ka bërë vërejtje se në arsim nuk janë bërë investimet të mjaftueshme.

“Në arsimin shqip s’ka investime të duhura, edhe sot mësuesit nuk i kanë kushtet si duhet. Veteranëve edhe sot sp’o u dilet haku si duhet. Sot në shumë shkolla tona mësimi zhvillohet në tri ndërrime.”, ka thënë Kurteshi.



Nënkryetarja e BSPK-së dhe poetja Leonora Lokaj ka lartësuar kujtimin për pishtarët e dijes nëpër shekuj dhe ka çmuar lartë kontributin e tyre në ruajtjen e arsimit dhe kulturës sonë kombëtare.



Në kuadër të këtij Manifestimi madhështor të pensionuarave të arsimit nga e tërë Kosova SBASHK-u u ka ndarë mirënjohje për punën e përkushtuar nëpër vite dhe nga një orë dore si simbolikë e kohës së kaluar në misionin human prej mësuesit.



Në emër të punëtorëve pensionistë të arsimit janë falënderuar mësuesi dhe veprimtari sindikal Zeqir Krasniqi dhe prof. Dr. Shpresa Hoxha.





## Duke respektuar zërin e anëtarësisë SBASHK-u vazhdon me veprimet sindikale

Pasi që i kishin dhënë kohë dhe hapësirë të konsideruar dialogut me institucionet e shtetit, SBASHK-u duke respektuar zërin e anëtarësisë mbajti takimin e jashtëzakonshëm të Këshillit Drejtues dhe duke zhvilluar një debat konstruktiv vendosi që të fillohej me veprime të përshakllëzuara sindikale. Veprimi i parë ishte ai i 14 shkurtit me grevën njëorëshe në të gjitha institucionet e arsimit të Kosovës. Kjo grevë tregoi për unitetin shembullor të SBASHK-ut.



Duke parë se institucionet nuk po reflektonin, më 20 shkurt u mbajt në nivel vendi greva dyorëshe. Po këtë ditë Kryeministri Haradinaj priti në kabinetin e tij delegacionin e SBASHK-ut. Në këtë takimi ishin edhe Ministrat Bytyqi e Hamza. Ishte kjo një përpjekje për gjetjen e mundësisë për realizimin e kërkësive të SBASHK-ut, por Ministri Hamza kishte kundërshtuar këtë angazhim duke thënë se nuk janë planifikuar mjete në buxhet për implementimin e Ligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet 90. Duke u gjendur në këtë situatë aktualiteti në arsim është debatuar edhe në Kongresin 7 të SBASHK-ut më 24 shkurt dhe delegatët kanë nxjerrë një Rezolutë për veprime sindikale, e cila ka

saktësuar datën 12 mars për grevën njëditëshe dhe ka dhënë 13 prillin për grevën e përgjithshme në kohë të pacaktuar e deri në realizimin të kërkesave legjitime e të bëra publike të SBASHK-ut.



Edhe Greva njëditëshe e 12 marsit tregoi unitetin dhe vendosmërinë e SBASHK-ut në rrugëtimin plot sfida për realizimin e kërkesave të anëtarësisë.



SBASHK-u është duke vazhduar me përpjekjet që me dialog të zgjedh çështjet, por është duke bërë përgatitje edhe për të nisur grevën e përgjithshme e në kohë të pacaktuar më 13 prill. SBASHK-u nuk vendosi me dëshirë për këto veprime, por nuk kishte zgjidhje e rrugëdalje tjetër. Në SBASHK urojnë që





Qeveria të reflektojë dhe të nis me realizimin e kërkesave të punëtorëve të arsimit në Kosovë, në mënyrë që të mos ketë nevojë për veprime sindikale.

Pikërisht në këtë përpjekje SBASHK-u alarmoi publikisht Qeverinë duke u kujtuar që të reflektojnë e të mos e presin 13 prillin sepse, si u tha publikisht, kur ka grevë në arsim, nuk ka mësim e madje as test PISA.

Dy takime të rëndësishme të Këshillit të ri Drejtues

## Nënkryetare u zgjedh Vjollca Shala e sekretare e përgjithshme Jehona Oruqi

Këshilli i ri Drejtues i SBASHK-ut ka zhvilluar dy takime në të njëjtën ditë në sallën e Qendrës së studentëve të selia e SBASHK-ut. Takimi i parë është mbajtur duke respektuar Statutin, i cili thotë se takimi zgjedhor i Këshillit Drejtues duhet mbajtur se largu 30 ditë pas Kongresit.



Në fillim të këtij takimi zgjedhor anëtarëve vtë rinj u ëhstë drejtuar kryetari i SBASHK-ut, Rrahman jasharaj, i cili ka

thënë:



"Të nderuar kolege e kolegë, anëtarë të rinj të Këshillit Drejtues ju përschendes dhe ju uroj angazhime konkrete në përfaqësimin sa më të denjë të anëtarësisë që ju ka dhënë besimin që ju për 4 vite me radhë të jeni pjesë e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut, që është organi më i rëndësishëm sindikatës sonë mes dy Kongreseve." Në vazhdim të këtij takimi sekretarja e përgjithshme e SBASHK-ut,

Jehona Oruqi ka prezantuar raportin e punës së kryetarit dhe kryesisë mes dy Kongreseve.



Pas kësaj Komisioni kandidues ka informuar Këshillin Drejtues me kandidaturën për nënkryetare dhe atë për sekretar të përgjithshëm.

"Vjollca Shala është kandidate për nënkryetare dhe kjo duke u bazuar në faktin se ajo ka përvojë të gjatë në angazhimet sindikale. Po ashtu ajo ka shënuar arritje fillimisht në komunën e saj duke mobilizuar pozitivisht punëtorët e arsimit atje dhe me shembullin e saj ka kontribuar që numri i anëtarëve të SBASHK-ut vazhdimisht të shtohet në Mitrovicë dhe se në zgjedhjet e bëra nëpër shoqata është rritur dukshëm angazhimi i femrave, të cilat janë zgjedhur për të udhëhequr shumë shoqata sindikale atje. Ka dhënë kontribut të madh në cilësinë e trajnerit në Trajnimet e organizuar nga SBASHK-u, me temën Ngritja e kapaciteteve të SBASHK-ut në Dialogun Social. Po ashtu do theksuar se kjo kolege me punë, korrektësi e angazhim ka krijuar respekt tek të punësuarit në arsim dhe kjo u dëshmuar edhe në Kuvendin e Sindikatave të Arsimit të Mesëm, në të cilin delegatët e zgjedhën Vjollcën për kryetare të këtij niveli arsimor", thuhet në

shkresën e nominimit të koleges Vjollca për nënkryetare të SBASHK-ut.



Edhe lidhur me kandidaturën e Jehona Oruçit që të rizgjidhet sekretare e përgjithshme është " Zonja Jehona Oruçi, e cila

edhe deri tani ka qenë sekretare e e përgjithshme dhe këtë detyrë, pasi është emëruar drejtore në një shkollë të Prishtinës, e ka kryer në mënyrë vullnetare, pra pa pagë mujore. Në bisedat me kolegen Jehona, ajo ka pranuar që të vazhdojë ta kryej detyrën e sekretares së përgjithshme, si edhe deri tani, në mënyrë vullnetare, pra pa pagë mujore deri në një vendim tjetër." është thënë në vlerësimin për znj. Jehona. Në vazhdim komisioni zgjedhor ka udhëhequr procesin e votimeve dhe pastaj ka shpallur rezultatet të cilat tregojnë se Këshilli Drejtues i jep besimin znj. Vjollca dhe znj. Jehona që të jenë në këto dy poste tejet të rëndësishme në SBASHK.



Në takimin e dytë Këshilli Drejtues ka shpallur e ka debatuar për shumë pika të rëndësishme të punës. Fillimisht ata janë njoftuar me 5 Rezolutat e Kongresit për t'u ndalur veçmas të Rezoluta për veprimet sindikale në përpjekje për të realizuar kërkesat e anëtarësisë. Në vazhdim të takimit ata janë njoftuar ne detaje për angazhimet që ka bërë kryetari Jasharaj dhe këshilltari për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri që përmes takimeve të shumta me përfaqësues të institucioneve të arrijnë që çështjet të realizohen përmes dialogut duke kujtuar takimet me Kryeministrin Haradinaj, Ministrat Bytyqi e Hamza dhe me shumë përfaqësues të tjerë të institucioneve." Duke parë se dialogu nuk po jep frytet e duhura në

fillim me veprimet sindikale, që ju i dini dhe ato treguan unitet të lartë të SBASHK-ut. Nëse gjendja vazhdon të jetë e njëjtë atëherë më 13 prill shkohet në grevë të përgjithshme në kohë të pacaktuar, gjegjësisht deri sa të plotësohen kërkesat tona të bëra publike", ka kujtuar Këshillin Drejtues, kryetari Jasharaj.



Në vazhdim të këtij takimi anëtarët e Këshillit Drejtues janë njoftuar me ndarjen e vendeve për pushime të anëtarësisë sipas komunave e

Universiteteve duke u bazuar në kriterin në çdo 54 anëtarë një pushues. Në kuvendet e sindikatave komunale dhe atë të universiteteve do të bëhet caktimi i shkollave dhe njësisive akademike që dërgojnë pushues, ndërsa anëtarët tonë në ato shkolla dhe njësi akademike do të zgjedhin pushuesit duke respektuar në përpikëri vendimin që thotë se prej tyre 40% duhet të jenë femra.



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka njoftuar Këshillin Drejtues me vendimin : " As një as kryetarët e niveleve komunale dhe

SUSHK-ut e as anëtarët e kryesisë së SBASHK-ut nuk shkojnë në këto pushime. Caktohet komisioni shoqëruar dhe kujdestar gjatë pushimeve. Caktohet nga niveli qendror, por me anëtarë nga regjionet dhe nga stafi. Përgjegjës për pushimet është këshilltari për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, i cili është i autorizuar të caktojë dhe të udhëheq me ekipet kujdestare gjatë dy turneve të pushimeve. Pra, do të shkojnë dy turne, e jo të gjithë në të njëjën kohë, gjegjësisht 210 pushues në turnin e parë dhe po aq pushues në turnin e dytë. Të respektohet në përpikëri ndarja tabelare sipas gjinisë. Nuk mund të bëhen zëvendësime me gjininë tjetër e as të bëhen zëvendësime në momentet e fundit. Njerëz me



sëmundje mos të dërgohen . Të vërtetohet se të nominuarit për pushime a janë anëtarë të SBASHK", thuhet në këtë vendim që është përkrahur nga Këshilli Drejtues.

Këshilli Drejtues është informuar se SBASHK-u do të punojë e do të angazhohet që të vazhdohet me aktivitete për dy trajnimet e licencuara dhe atë Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social, gjithsej 32 orë trajnim dhe Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin Parauniversitar", 32 orë trajnim. për çka janë caktuar edhe kriteret.



Ministri Bytyqi ka organizuar takim të nivelit të lartë për arsim

## **SBASHK-u alarmoi se nëse nuk ka reflektim do të ketë grevë në kohë të pacaktuar**

Ministri i arsimit , Shyqyri Bytyqi ka organizuar një takim të nivelit të lartë për gjendjen në arsim. Takimi është mbajtur në ambientet e ndërtesës së Qeverisë dhe në të ishin të pranishëm kryeministri Ramush haradinaj, zv/kryeministrat Lima e Hoxhaj, përfaqësues të SBASHK-ut rektorë e prorektorë, drejtorë të DKA-ve dhe pjesëmarrës të tjerë.



Në hapje të këtij takimi Ministri Bytyqi është shprehur se është ky një moment i veçantë për të biseduar bashkërisht e për të kontribuar me ide që të kemi një arsim sa më të mirë.

Kryeministri Haradinaj është shprehur se ky është një fillim i ri dhe se takime në një përmbajtje të tillë është mirë të organizohen së paku çdo muaj. Ai pastaj është shprehur se duhet dhënë secili kontributin e tij në

mënyrë që ta përmirësojmë gjendjen në arsimin e Kosovës, duke veçuar se as SBASHK-u vetëm po as edhe të tjerët pa i bashkuar angazhimet nuk mund t'ia dalin këtij misioni. Kryeministri Haradinaj veç tjerash tha se është i interesuar që të rregulloj gjendejn në arsim pa kërkuar fajtorë dhe i tojë të gjithë akterët që të jenë të përkushtuar që ta përmirësojmë gjendjen ekzistuese.



Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj nuk ka hezituar që edhe në këtë takim të rikujtojë se po flet si zë i të gjithë të punësuarve në arsim dhe i është drejtuar Kryeministrit dhe zv/Kryeministrave që të kontribuojnë në realizimin e kërkesave të SBASHK-ut, që janë kërkesa të mësimdhënësve të Kosovës, duke kujtuar se nëse kjo nuk ndodhë, do të veprohet sipas Rezolutës së Kongresit të 7-të të SBASHK-ut për veprime sindikale, që do të thotë se data 13 prill 2018 e gjen Kosovën në grevë të përgjithshme të arsimit.

SBASHK-u pjesëmarrës edhe në një ngjarje ndërkombëtare për arsimin

## Sindikalistët nga e tërë Evropa diskutuan për sfidat në arsim

Në kryeqytetin e Bullgarisë, që është kryesuese e Këshillit të Evropës nga marsi i këtij viti, është organizuar Konferenca ndërkombëtare në mbështetje të arsimit dhe veçmas të mësimdhënësve të rinj.



Këtë ngjarje të rëndësishme e ka organizuar Sindikata e punëtorëve bullgar të arsimit e ndihmuar nga Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës

dhe Ministrisë së Arsimit të Bullgarisë, në këtë Konferencë ,krahas shumë shteteve të Ballkanit e Evropës, ka marrë pjesë edhe SBASHK-u duke përfaqësuar në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare arsimin e Republikës së Kosovës.

Në hapje të kësaj konference, kryetarja e Sindikatës së mësuesve të Bullgarisë, Janka Takeva ka përshëndetur delegacionet pjesëmarrëse duke apeluar te ta që të kontribuojnë me prezantimet e tyre për të parë nga afër gjendjen në arsim në vendet e Ballkanit e Evropës.



“Kjo është ngjarje e rëndësishme për të gjithë ne në kohën kur arsimi kudo në vendet nga vijmë ne është

para sfidave të shumta dhe si gjithmonë ne do të tregojmë solidaritetin sindikal dhe bashkërisht me presidenten e Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Kristine Blover dhe drejtoreshën e këtij Komiteti për Evropën Suzan Flocken do të mundohemi të ofrojmë ide e propozime konkrete se si të tejkalohen bashkërisht këto sfida”, është shprehur , kryetarja e Sindikatës së mësuesve të Bullgarisë, Janka Takeva. Pjesëmarrësit e kësaj Konference i ka përshëndetur pastaj Ministri i Arsimit të Bullgarisë

Krasimir Valshev, i cili është shprehur se sindikatat kanë rol kyç në angazhimet në shërbim të arsimit në çdo shtet.



Presidentja e Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës , Kristine Blover e ka çmuar si të rëndësishme

këtë ngjarje duke kujtuar se të 11 milionë anëtarët e këtyre sindikatave evropiane presin që të ndihen të mbrojtur në përballje me sfidat e shumta. “ “këtu po përfaqësojmë anëtarësinë nga shumë shtete të Ballkanit dhe Evropës dhe duhet të angazhohemi edhe në të ardhmen që punëtorët e arsimit të kenë paga dinjitoze dhe t’u sigurohen nga qeveritë kushte të mira të punës në mënyrë që më lehtë të realizohet përkushtimi për arsimim e edukim të fëmijëve të atyre shteteve, por edhe të fëmijëve refugjatë, kudo janë ata.

Drejtorja e ETUCE , Suzan Flocken ka ngritur shqetësimin se si të veprohet në kohën kur në shumë shtete 32 % e të punësuarve në arsim janë të moshës mbi 50 vjet, ndërsa në arsimin e mesëm kjo shifër arrin në 36% .



Ajo ka kritikuar se shumë shtete ende nuk ndajnë buxhet të mjaftueshëm për arsim dhe se është pyetje e kohës se si të bëhet atraktiv profesioni i mësuesit, pasi siç u tha nga disa pjesëmarrës në shtetet e caktuara po hetohet mungesë e kadrove të profilit të arsimit sepse një pjesë e kadrove të shkolluara për punën në arsim duke u gjendur para presioneve të kohës po kërkojnë punë në sektorë të tjerë.



Pas kësaj kontribut të çmuar në temën kyçe "Mbështetja e mësimdhënësve të ri është shumë e rëndësishme për arsimim kualitativ" kanë dhënë ekspertit i arsimit nga Irlanda, Loan Rusell Marko Snoek nga Universiteti i Amsterdemit dhe ekspertë të tjerë nga Bullgaria dhe shtete të tjera.

Kontribut të çmuar në këtë Konferencë ka dhënë edhe delegacioni i SBASHK-ut.

Kryetari Rrahman Jasharaj ka deklaruar se në arsimin e Republikës së Kosovës në momentin aktual janë duke punuar tri gjenerata mësuesish dhe se një pjesë e tyre janë pra edhe gjenerata e re që viteve të fundit kanë kryer arsimimin adekuat për mësimdhënës dhe se ata kanë mbështetjen e kolegëve të tyre me përvojë, të cilët u ndihmojnë të rinjve që të hedhin hapat e parë të këtij mision të shenjtë të arsimimit e edukimit të brezave.

Gjatë pauzave të Konferencës kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me këshilltarin për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë zhvilluar takime të ndara me përfaqësues të shumë sindikatave nga Ballkani e Evropa duke shikuar mundësinë e forcimit të vazhdueshëm të bashkëpunimit me qëllim të bartjes së përvojave sindikale.



Trajnim për udhëheqje dhe planifikim strategjik në Arsimin Parauniversitar

## Sindikalistët nga Mitrovica me mjete të kursyera nga fondi komunal sindikal

Në përpjekje për ngritje të vazhdueshme të kuadrove sindikale në aspektin e njohurive të reja për dialogun social dhe të udhëheqjes, SBASHK-u ka marrë licencë nga komisioni gjegjës në MASHT për dy trajnime me anëtarësinë dhe atë "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social" dhe "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" është filluar me trajnimin lidhur me përgatitjen e kuadrove të reja për udhëheqje sindikale dhe në institucione arsimore.



Në trajnimin "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" kanë marrë pjesë kryetarët e shoqatave sindikale nga shkollat e komunës së Mitrovicës. Ky aktivitet me rëndësi është i mbuluar materialisht nga mjetet e kursyera nga fondi sindikal komunal.

Duke hapur punimet e këtij trajnimi nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala është shprehur se Mitrovica është shembull i mirë i unitetit dhe angazhimit sindikal dhe se duke kursyer mjetet nga fondi sindikal komunal bashkërisht jemi në këtë aktivitet të rëndësishëm që jep mundësi të fitohen njohuri konkrete për udhëheqje dhe planifikim strategjik në arsim.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj në fjalën përshëndetëse ka lavdëruar arritjet sindikale në komunë e Mitrovicës duke theksuar se edhe ky aktivitet që ata po zhvillojnë është falë përkushtimit dhe angazhimit të kryetares, kryesisë, por edhe të veprimtarëve tjerë sindikal në këtë komunë që duke

ruajtur me kujdes fondin sindikal komunal kanë arritur të zhvillojnë shumë aktivitete në të kaluarën dhe këtë aktivitet shumë të rëndësishëm.



Njohësi i mirë i kësaj lamie, trajneri i licencuar, Safet Beqiri ka shpalosur programin e këtij trajnimi duke u ndalur fillimisht te profili i udhëheqësit të suksesshëm të shekullit 21. Trajneri Beqiri ka sjellë shumë shembuj konkret për të ilustruar më mirë e për ta bërë më të lehtë të kuptuarit e këtyre çështjeve. Kjo pjesë e trajnimit ka fituar në dinamikë ngase është zhvilluar përmes bashkëbisedës dhe pjesëmarrësit kanë dhënë idetë dhe mendimet e tyre për profilin e liderit dhe menaxherit. Trajneri Beqiri ka nxitur debat mes pjesëmarrësve, të cilët kanë portretizuar udhëheqësin,

por edhe menaxherin e mirë dhe atë që nuk meriton të jetë në këto pozita udhëheqëse e menaxhuese.



Trajneri i licencuar Ymer Ymeri ka dhënë një kontribut të çmuar gjatë gjithë trajnimit duke u ndalur te llojet e udhëheqjes dhe udhëheqësve e duke marrë shembuj konkret nga realiteti ekzistues në Kosovë, sidomos në sektorin e arsimit.

Pjesëmarrësit në këtë trajnim janë shprehur se aktiviteti i tillë është shumë i qëlluar dhe se ata janë duke marrë njohuri të reja rreth udhëheqjes dhe planifikimit strategjik dhe këto njohuri do t'u shërbejnë në të ardhmen duke i përdorë në angazhimet e tyre sindikale dhe në procesin edukativo-arsimor.

Deputetja Teuta Haxhiu vizitoi SBASHK-un

## Përkushtim i të dy palëve në shërbim të arsimit

Deputetja dhe nëkryetarja e Komisionit Parlamentar për Arsim, znj. Teuta Haxhiu ka vizituar selinë e SBASHK-ut dhe është takuar me kryetarin Rrahman Jasharaj dhe menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë njoftuar zonjën Haxhiu me situatën aktuale në arsim duke treguar edhe për veprimet sindikale dhe duke alarmuar se nëse nuk ka reflektim të duhur të Qeverisë më 13 prill i tërë sistemi arsimor në Kosovë do të jetë në grevë në kohë të pacaktuar, e cila do të zgjas deri sa nuk realizohen kërkesat e bëra publike të SBASHK-ut.





Znj.Haxhiu ka shprehur respekt të lartë për punëtorët e arsimit, duke qenë dikur njëra nga ato dhe ka thënë se ka gatishmërinë që në Komisionin Parlamentar për Arsim, por edhe në seancat e parlamentit të ngris çështje në shërbim të arsimit. Ajo i ka bërë apel SBASHK-ut që krahas angazhimeve në mbrojtjen e të drejtave dhe realizimin e kërkesave të anëtarësisë, të vazhdojë edhe me kontributin për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim.

Kryetari i SBASHK-ut bashkë me menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë njoftuar znj.Haxhiu me gjithë angazhimet duke alarmuar se arsimi në Kosovë është në fazën e veprimeve sindikale dhe nëse kërkesat nuk realizohen shumë shpejt, atëherë i tërë sistemi arsimor me datë 13 prill 2018 e tutje do të gjendet në grevë të përgjithshme, e cila nuk do të përfundojë derisa nuk realizohen kërkesat e SBASHK-ut, të cilat i di Qeveria por edhe i gjithë opinioni.



Nënkryetarja e Komisionit Parlamentar për Arsim është shprehur e bindur se Qeveria dhe Institucionet në përgjithësi do të angazhohen që ligji për statusin e mësimdhënësve të arsimit shqip të viteve të '90-ta të marr dritën e gjelbër në Qeveri për t'u proceduar pastaj për votim në Parlamentin e Kosovë.